



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:156339

Datë: 19.02.2021

Numri i dokumentit: 01521582

**P.nr.1021/20**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**Gjykata Themelore në Prizren** - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Shpresa Emra me pjesëmarrjen e sekretares juridike Birsen Shoshani, në çështjen penale kundër të akuzuarit M.O. nga .... Komuna e Prizrenit, për shkak se ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 dhe 2 të KP, sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.1148-1/20 e dt. 11.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, Prokurorit të Shtetit Mehreme Hoxha, të dëmtuarës H.O. dhe të akuzuarit me datë 11.02.2021, publikisht mori dhe shpalli këtë:

### **A K T G J Y K I M**

#### **I akuzuari:**

**M.O.** nga i ati F. dhe e ëma A. e lindur M. i lindur më .... në .... Komuna e Prizrenit, ku edhe jeton, i martuar, babë 3 fëmijëve, boshnjak, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues i ndihmës sociale, identifikohet me letër njoftim nr.pers. ....

### **ËSHTË FAJTOR**

Se me datë 30.05.2020, rreth orës 17,40 minuta në .... Komuna Prizren, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare, kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër, brenda një marrëdhënie familjare, ndaj të dëmtuarës-bashkëshortes së tij H.O. pasi që i pandehuri kishte një mosmarrëveshje paraprake me bashkëshorten e tij lidhur me një çokollatë, i pandehuri me atë raste e sulmon fizikisht të dëmtuarën H.O. duke e goditur me grusht në kokë dhe në fytyrë, me të cilat veprime te e dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës, shqetësimin dhe rrezikshmërisë personale.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 dhe 2 të KP.**

Andaj gjykata me në harmoni me nenet ,8,9,10,38,39,40,46,47,48,49,69 dhe të nenit 248 par. 1 të KP të akuzuarit i shqipton

### **DENIM ME BURGIM ME KUSHT**

Duke ia vërtetuar dënimin me burg në kohëzgjatje **prej 6 ( gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit **prej 1 ( një) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale dhe **DENIM ME GJOBË ME KUSHT** duke ia vërtetuar dënimi me

gjobë në lartësi **prej 200 ( dyqind) €**, po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit **prej 1 ( një) viti** nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, të gjitha këto duhen të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse të akuzuarit i revokohet dënimi me gjobë i kushtëzuar dhe dënimi me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, atëherë gjykata këtë dënim do t'ia zëvendësoj të akuzuarit me dënim me burgim duke llogaritur 20 Euro, për një ditë burgimi, respektivisht me 10 (dhjetë) ditë burgim.

I akuzuari lirohet nga shpenzimet procedurale pasi që është shfrytëzues i ndihmës sociale.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate ka parashtruar Aktakuzë PP/II.nr.1148-1/20 e dt. 11.11.2020 kundër të akuzuarit M.O. nga .... Komuna e Prizrenit, për shkak se ka kryer veprën penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 të KP.

Gjykata në këtë çështje penale, respektivisht duke vepruar sipas Aktakuzës ka caktuar shqyrtimin fillestar, në të cilin shqyrtim i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilët akuzohet sipas aktakuzës.

Bazuar në aktin e pranimit të fajësisë dhe konform dispozitave të nenit 246 e 248 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtimin ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 30.05.2020, rreth orës 17,40 minuta në fsh. .... Komuna Prizren, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare, i akuzuari kryen dhunën ose keqtrajtimin fizik, me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër, brenda një marrëdhënie familjare, ndaj të dëmtuarës-bashkëshortes së tij H.O. pasi që i pandehuri kishte një mosmarrëveshje paraprake me bashkëshorten e tij lidhur me një çokolletë, i pandehuri me atë raste e sulmon fizikisht të dëmtuarën H.O. duke e goditur me grusht në kokë dhe në fytyrë, me të cilat veprime të dëmtuara ka shkaktuar ndjenjën e frikës, shqetësimit dhe rrezikshmërisë personale.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, për shkak së cilës gjykata fare nuk ka administruar provat.

Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzime. Pranimi i fajësisë mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë me të gjitha provat materiale.

Gjykata erdhi në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së dhe faktet që përmban aktakuza, ku në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të dhunës në familje nga neni 248 par. 1 të KP, ku për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe ia shqiptoi dënimin me kusht në kohëzgjatje

prej 6 ( gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 ( një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale dhe dënim me gjobë me kusht në shumë prej 200 ( dyqind )€ po qe se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 ( një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Gjatë marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit.

Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata si rrethanë rënduese konsideron faktin se kemi të bëjmë me veprën penale të dhunës në familje, ndërsa si rrethana lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga i akuzuari në shqyrtimin fillestar, pendimi i tij dhe premtimi i dhënë gjykatës që nuk do të ndodh më. Gjithashtu e dëmtuara H.O. ka deklaruar se me bashkëshortin në ndërkohë i kanë rregulluar raportet, janë në pritje të fëmijës së katërt dhe nuk dëshiron që bashkëshorti i saj të dënohet. Janë të gjendjes së dobët ekonomike, shfrytëzues së ndihmës sociale.

Andaj duke u bazuar në këto rrethana, gjykata të akuzuarit i shqiptoi sanksionin penal sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se sanksioni shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penalo juridike të tyre dhe se me këtë sanksion do të arrihet qëllimi preventiv i dënimit që në të ardhmen të jenë më të kujdesshëm dhe të përmbahen nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi lirimin nga shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 453 par.4 të KPP-së, për shkak të faktit se i akuzuari është i gjendjes së dobët dhe është shfrytëzues i ndihmës sociale.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr.1021/20 e dt. 11.02.2021**  
**2020:156339, 19.02.2021**

**G j y q t a r i**

---

**Shpresa Emra**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimin të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.